

RAPORTI STATISTIKOR

JANAR - PRILL

2022

Hyrje

Raporti synon të japë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara të Tregut të sigurimeve dhe me pas të shoqërisë Insig sh.a për periudhën janar-prill 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si edhe për tregues specifikë të dhënat krahasohen për periudhën janar-prill të viteve 2018 - 2022. Në përfundim të raportit ndërtohen projeksione dhe jepen vlerësime të mbështetura në fakte dhe gjykime.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet raporti janë; Buletini Statistikor zyrtar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën janar-prill 2022 dhe të dhënat statistikore të përpunuara për periudhën në shqyrtim, të shoqërisë Insig Sh.a.

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Prill 2022.....	3
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës	3
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës	7
2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Prill 2022	9
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të aksidenteve	11
2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike	11
2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës	13
2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera.....	13
2.5 Përpjesa e klasave të sigurimit në raport me totalin.....	14
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar -Prill 2022.....	15
3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike	16
3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit	17
4.Projeksiione dhe vlerësime	17


1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Prill 2022

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-prill 2022 ka grumbulluar 5,841,136,603 lekë prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimit të Jetës dhe Jo Jetës, duke shënuar rritje me 9.09% krahasuar me muajt janar-prill 2021. 92.12% të këtyre primeve realizohet nga sektori i Jo Jetës, pjesa tjetër prej 7.83% nga sektori i Jetës, kurse veprimtaria e risigurimeve primet e realizuara janë vetëm 0.04% e totalit. Vlera e dëmeve të paguara nga industria e sigurimeve është 2,172,850,224 lekë në rënie 14.54% krahasuar me muajt janar-prill të vitit 2021. Njësoj si treguesit e primeve të shkruara, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara afro 91.10% e tyre paguhet nga aktiviteti i Jo Jetës, 4.24% e tyre nga aktiviteti i Jetës dhe 4.67% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit.

1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës

Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës është 5,381,003,248 lekë duke shënuar rritje me 8.44% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Ndikimin kryesor në rezultatin e rritjes së përgjithshme të tregut e japin sigurimet e detyrueshme motorike me 13.53%, ndërkohë frenojnë rritjen sigurimet e zjarrit dhe dëmtimeve të tjera në pronë, të cilat pësojnë rënie me afro 7.45%. Ndikimi i tyre i rëndësishëm vjen nga përpjesa që ata kanë në totalin e tregut. Pas dy mujorit të parë të vitit ku tregu ishte me rënie, rritja ka ardhur si pasojë edhe e rënies së përpjesës që sigurimet e zjarrit dhe dëmtimeve të pronës nga 19.02% në vitin 2021 në 16.23% në vitin 2022. Përveç sigurimeve të pronës, edhe sigurimet e kreditit dhe garancisë; përgjegjësiive civile janë me rënie, ndërsa pjesa e tjetër e sigurimeve shënojnë rritje krahasuar me janar-prill 2021. Në grafikun 1 ilustrohen vlerat në përqindje ndryshimi për secilën klasë sigurimi të periudhës janar-prill 2022/2021.


Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, janar-prill 2022/2021



Burimi: AMF, përpunoi autori

Nga ana tjetër, sipas ecurisë së primeve të shkruara bruto të muajve janar-prill për vitet 2018-2022 trendi i tyre është i çrregullt krahasuar me vitin paraardhës. Kurba e ecurisë së primeve të tregut paraqet kulmin e saj në janar-prill të vitit 2022. Vlera më e ulët e primeve të realizuara është në vitin 2020. Grafikisht, viti 2020 evidentohet si pikë thyerje nga ritmi i rritjes, kjo pasi muaji prill i vitit 2020 ishte ndër muajt në të cilën u ndjenë më së shumti pasojat ekonomike të pandemisë Covid 19 në Shqipëri. Bazuar në parashikimet e Bankës Botërore për vitin 2022, pritej që ekonomia e Republikës së Shqipërisë të ringrihej, pas goditjeve të tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë Covid 19. Norma e rritjes përlllogaritej afro 3.8% dhe gjashtë mujori i parë i vitit 2022 pritej të sillte stabilitet të çmimeve dhe normës së inflacionit, mirëpo parashikimet janë tërhequr duke u bazuar në ngjarjet aktuale të ndodhura në botë, që pritet të kenë ndikim edhe në tregun vendas. Megjithatë, për shifrat deri në katërmujorin e parë të vitit 2022 vlera e primeve të realizuara është më e larta e realizuar duke ndjekur ritmin e rritjes nga viti 2020.


Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto tregu i sigurimeve, janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)



Burimi: AMF, përpunoi autori

Tregu vazhdon të dominohet nga klasa e sigurimeve të detyrueshme motorike duke zotëruar 61.95% të totalit të primeve të shkruara bruto, e ndjekur më pas me rreth 16.23% nga sigurimet e pronës ndërsa pjesa tjetër e ndarë midis klasave të tjera. Ndarja e përpjesës së sigurimeve grafikusht paraqitet në grafikun 3, ku vihet re struktura pothuajse e njëjtë e llojeve të sigurimit që dominojnë tregun e sigurimeve si gjatë vitit 2021, me diferencë të lehtë në përpjesën e llojit të sigurimit zjarr dhe dëmtimet e tjera në pronë, e cila po humb përpjesën e saj në totalin e primet të tregut. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, pjesa ndaj totalit e sigurimeve të zjarrit dhe dëmtimeve të tjera në pronë ishte 19.02%, ndërsa gjatë vitit 2021 zbrit në 16.23%.


Grafiku 3: Përpjesa e primeve bruto sipas të llojit të sigurimeve ndaj totalit, janar-prill 2022



Burimi: AMF, përpunoi autori

Referuar grafikut 4, ku paraqitet raporti i sigurimeve vullnetare me ato të detyrueshme për muajt janar-prill përpjesa që sigurimet vullnetare zënë ndaj sigurimeve totale është më e madhe në muajt janar-prill të vitit 2021 me 40.82% prime vullnetare ndaj totalit. Ndërkohë që raporti më i ulët paraqitet në muajt janar-prill të vitit 2018, i cili rezulton afro 34.83%. Për periudhën raportuese raporti rezulton 38.05% me 61.95%.

Grafiku 4: Raporti vullnetare/totalit për periudhën janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)




Burimi: AMF, përpunoi autori

Nga sigurimet e detyrueshme motorike, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë rezultojnë të gjitha me rritje si, sigurimet TPL (+8.44%), kufitare (+53.67%), dhe kartoni jeshil (+6.60%). Periudha krahasuese është janar-prill i vitit 2021, periudhë nën efektet e pandemisë, kështu që rritja e volumit të primeve nga këto lloje sigurimesh është e pritshme, pasojë e përmirësimit të ndjeshëm ekonomik post covid. Numri i kontratave të lidhura për sigurimet e Jo Jetës gjatë muajve janar-prill 2022 është 295,813 kontrata, duke shënuar rritje prej 23.31% më shumë se një vit më parë. Klasa e sigurimeve motorike vullnetare dhe marinë, aviacion dhe transport janë të vetmet klasa me rënien në numrin


e kontratave të nënshkruara, repektivisht -22.09% dhe -3.81%, ndërsa pjesa tjetër shënon rritje, ku rritjen më të madhe e mban klasa e sigurimeve të aksidenteve.

Grafiku 5: Ndarja e tregut të Jo Jetës, janar-prill 2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

Grafiku 6: Norma e rritjes së primit, janar-prill 2022/2021



Burimi: AMF, përpunoi autori

Grafiku 7: Raporti vullnetare/totalit, janar-prill 2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës

Gjatë periudhës janar-prill 2022 nga aktiviteti i sigurimit të Jo Jetës janë paguar 1,979,385,742 lekë dëme, shifër në rënie krahasuar me janar-prillin e vitit 2021, 15.14% më pak dëme të paguara, kjo si pasojë e vlerës së lartë të bazës krahasuese të vitit 2021.


Grafiku 8: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), janar-prill 2018-2022



Burimi: AMF, përpunoi autori

Siç ilustron dhe në grafikun 8, vlera më e lartë e dëmeve të paguara është në muajt janar-prill të vitit 2020 për gjithë periudhën e viteve 2018-2022. Faktori kryesor ndikues në këtë tregues janë tërmetet e ndodhura në fund të vitit 2019 në vend dhe pasojat që ata shkaktuan, duke bërë që vlera e dëmeve dhe për pasojë e dëmshpërblimeve nga siguruesit të jetë më e lartë së çdo vit tjetër gjatë vitit 2020 dhe 2021. Gjatë periudhës janar-prill 2022 vlera e dëmeve të paguara është ulur, mirëpo numri i dëmeve të paguara është rritur, duke u paguar kështu 18,115 dëme, rritje me 12.49% nga 2021. Kjo tregon për uljen e shkallës së ashpërsisë së dëmeve të paguara dhe rritjen e shpeshtësisë së tyre. Siç vihet re në grafikun 9, për periudhën janar-prill 2022 dëmet e paguara për sigurimin e zjarrit dhe dëmtimeve të tjera në pronë kanë pësuar rënie me rreth 50.28%, rënie po ashtu është edhe klasa e sigurimeve motorike vullnetare (-21.19%) dhe aksidenteve (-5.38%). Ndërkohë klasat e tjera të sigurimeve shënojnë rritje, ku rritjen më të madhe e mban klasa e sigurimeve marinës, aviacionit dhe transporti (+887.15%). Klasa e sigurimeve motorike të detyrueshme (përgjegjësi ndaj palëve të treta) shënon rritjen prej afro 6.15%. Për klasën e sigurimeve të zjarrit dhe dëmtimeve të pronës, në të njëjtin kohë me vlerën e dëmeve të paguara shkon edhe numri i dëmeve të paguara, duke pësuar rënie në numër me 51.46%. Klasa e sigurimeve të aksidenteve dhe sëmundjeve në vlerë pëson rënie të dëmeve të paguara, ndërsa numri i tyre është në rritje me 13.03%.


Grafiku 9: Ndryshimi në dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve, janar-prill 2022/2021¹



Burimi: AMF, përpunoi autori

Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vjen nga lloji i sigurimeve motorike rreth 70.54% e totalit, ndjekur nga sigurimet aksidenteve dhe shëndetit 10.22% dhe pjesa tjetër nga të tjera.

Grafiku 10: Përpjesa e dëmeve të paguara sipas klasës së sigurimeve, janar-prill 2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

Referuar të dhënave, raporti dëme/prime rezulton të jetë 36.78% gjatë muajve janar-prill 2022, afro 10.22% më pak se raporti dëme/prime i vitit 2021. Raporti llogaritet për të matur efikasitetin e tregut të sigurimeve, duke treguar se ç'pjesë të primeve të grumbulluara shkon për pagesën e dëmeve. Në vendet e zhvilluara ky raport është mbi 50%, megjithatë raporti duhet të variojë në varësi të natyrës së llojit të sigurimit. Për sigurimet e detyrueshme motorike, kjo klasë duhet të ketë raportin më të lartë dëme/prime, pasi në këtë mënyrë realizon qëllimin e aktivitetit të tij, afërsisht në tregun e vendit tonë ky raport për sigurimet e detyrueshme motorike është afro 35.86%.

¹ Grafiku 9 nuk përfshin ndryshimin në dëmet e paguara për klasën e marinës, aviacionit dhe transportit, si pasojë e përqindjes shumë të lartë të ndryshimit (+887%), e cila në ilustrimin grafik do shpërfillte ndryshimet e tjera.

Grafiku 11: Përpjesa e dëmeve të paguara nga secila shoqëri sigurimi, janar-prill 2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Prill 2022

Nga krahasimi i të dhënave më të fundit të publikuara nga AMF për Tregun e Sigurimeve të Jo Jetës, aktiviteti i shoqërisë INSIG për periudhën janar-prill 2022, u mbyll me një rezultat primesh të shkruar bruto prej 362,518 mijë lekë, **duke shënuar një rritje prej 3.75%** ose 13,108 mijë lekë më shumë krahasuar me janar-prill të vitit 2021 dhe një rritje prej 23.16% ose 68,164 mije lekë më shumë në raport me janar-prill të 2020. Referuar krahasimit me periudhën janar-prill të vitit 2019 rezulton me një rritje prej 15.92%. Krahasuar me periudhën janar-prill nga vitet 2018 – 2022, ecuria e primeve të shoqërisë Insig është pothuajse jo e rregullt, duke shënuar vlerën më të ulët në janar-prill të 2020-ës dhe vlerën më të lartë të primeve të realizuara në janar-prill të vitit 2022 paraqitur grafikisht si më poshtë në grafikun 12.

Grafiku 12: Ecuria e primeve të shkruara bruto Insig, janar-prill 2018-2022 në mijë lekë



Burimi: AMF & INSIG

Nga këndvështrimi i ndarjes më specifike të biznesit, në Sigurime të Detyrueshme dhe Vullnetare për periudhën janar-prill 2022, rezultojnë përkatësisht strukturat e mëposhtme me dominancë të qëndrueshme të sigurimeve të detyrueshme.

Raporti i Sigurimeve të Detyrueshme dhe Vullnetare ndaj Totalit për Janar-Prill 2021-2022

(në mijë lekë)

PRODUKTET	Tregu	Insig	Tregu	Insig
janar-prill 2022				
Sig Detyrueshme	3,333,764	298,482	62%	82%
Sig Vullnetare	2,047,239	64,036	38%	18%
TOTALI	5,381,003	362,518	100%	100%
janar -prill 2021				
Sig Detyrueshme	2,936,360	256,023	59%	73%
Sig Vullnetare	2,025,741	93,387	41%	27%
TOTALI	4,962,101	349,410	100%	100%


Burimi: AMF&INSIG

Për Tregun 2022: Të Detyrueshme 62%, Vullnetare 38% (janar-prill 2021: 59% me 41).

Për INSIG 2022: Të Detyrueshme 82%, Vullnetare 18% (janar-prill 2021: 73% me 27%).

Prej këtej vihet re se, për Tregun kemi një zhvendosje me 3% nga sigurimet vullnetare drejt atyre të detyrueshme, ndërsa për Insig kemi zhvendosje në po të njëjtin kah me Tregun po me 9%. Kemi një tendencë të theksuar në rritje drejt sigurimeve të detyrueshme si për Tregun ashtu edhe për Insig dhe rënie për sigurimet vullnetare. Tregues jo i mirë rezultati në rënie i sigurimeve vullnetare për periudhën janar-prill të 2022 krahasuar me 2021. Raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit për janar-prill 2022 është 17.66% me 82.34%, duke pasur një rënie të këtij raporti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ku raporti i vullnetareve ndaj totalit ishte 26.73% dhe mban vlerën më të lartë të pesë vjecarit. Ecuria e këtij raporti për periudhën janar-prill 2018-2022 paraqitet sipas grafikut 13 .

Grafiku 13: Prime vullnetare ndaj totalit Insig, janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)




Burimi: AMF & INSIG

Duke ju referuar produkteve qe zënë peshën kryesore në totalin e të ardhurave, por edhe atyre për të cilat disponohen të dhëna nga tregu, konstatohet se pesha e INSIG ndaj Tregut ka ndryshuar respektivisht si më poshtë:

2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të aksidenteve

Gjatë periudhës janar-prill 2022 nga klasa e sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit janë realizuar 5,201 mijë lekë prime të shkruara bruto duke shënuar një rritje me 29.48% ose 1,184 mijë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Kjo rritje është shoqëruar edhe me rritjen e numrit të kontratave prej 128.48%. Primet e realizuara nga ky grup në raport me totalin janë 1.43% tyre. Grafiku 14, ilustron ecurinë e primeve të shkruara bruto për periudhën janar-prill nga 2018 – 2022. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara shënohet për periudhën janar-prill të vitit 2021, si pasojë e masave tepër shtrënguese të vendosura nga qeveria në fillim të këtij viti prej pandemisë Covid 19, ndërsa më e larta për periudhën janar-prill të 2019-ës.

Grafiku 14: Primet e shkruara bruto klasa e aksidenteve Insig, janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)




Burimi: AMF & INSIG

2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike

Në klasën e sigurimeve motorike, përfshihen sigurimet e detyrueshme motorike TPL, Karton Jeshil, Kufitare dhe sigurimet vullnetare motorike, Kasko. Nga klasa e sigurimeve motorike shoqëria Insig për periudhën janar-prill 2022 ka grumbulluar 315,882 mijë lekë prime të shkruara bruto, **duke shënuar rritje me 14.63%** e cila u shoqërua edhe me rritjen e numrit të kontratave prej 23.32% krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2021. Referuar krahasimit me periudhën janar-prill të 2020-ës rezulton me një rritje prej 30.83%. Vetëm nga sigurimet e detyrueshme motorike primet e shkruara bruto janë 298,043 mijë lekë, të cilat përbëjnë rreth 82.21% të gjithë primeve të klasës motorike. Nga sigurimet e detyrueshme motorike për periudhën janar-prill 2022, TPL zë pjesën më të madhe dhe krahasuar më të njëjtë periudhë të 2021, ka një rritje prej 10.21% e cila u shoqërua edhe me rritjen e numrit të kontratave prej 10.48%. Kartoni Jeshil ka rritje prej 68.85% dhe kjo u shoqërua me rritjen e numrit të kontratave prej 193.2%. Kufitarja ka një rritje prej 7.02%, e cila u shoqërua me rritjen e numrit të kontratave prej 8.25%. Ndërkohë për periudhën

janar-prill 2022, primet e shkruara bruto për sigurimin Kasko janë 17,839 mijë lekë, duke shënuar një rënie prej 8.68% ose 1,696 mije leke më pak, e cila u shoqërua edhe me rënien e numrit të kontratave prej 6.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Primet e kësaj klase zenë 5.65% të totalit të motorikeve. Primet e realizuara nga sigurimet motorrike, bëjnë pjesën më të madhe të totalit të primeve të INSIG, duke zënë respektivisht 87.14% të tij. Për vitet 2018–2022 trendi i primeve të sigurimeve të detyrueshme motorrike është i luhatshëm, ku vlera më e ulët shënohet për janar-prill të 2020-es dhe vlera më e lartë në janar-prill të 2022-it sipas grafikut 15.


Grafiku 12: Ecuria e primeve - klase e sigurimeve motorrike të detyrueshme Insig, janar-prill 2018 - 2022 (mijë lekë)



Burimi: AMF & INSIG

Trendi i primeve të realizuara për sigurimet Kasko, është i luhatshëm duke parë ecurinë për periudhën janar-prill nga 2018 ne 2022, ku vlera më e ulët shënohet në janar-prill të 2018-ës dhe vlera më e lartë në janar-prill të vitit 2021. Kemi një tendence ulje dhe ngitje të këtij produkti, tregues jo shumë pozitiv duke marrë parasysh faktin që produktet Kasko bëjnë pjesë në produktet vullnetare. Në grafikun 16 ecuria e primeve Kasko 2018-2022.

Grafiku 13: Ecuria e primeve Insig – klase e sigurimeve kasko, janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)




Burimi: AMF

2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës

Në klasën e sigurimeve të pronës sipas të dhënave të AMF-së, përfshihen përveç sigurimeve nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtime të tjera në Pronë edhe sigurimet e punimeve në ndërtim si CAR apo dhe EAR. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar-prill 2022 është 18,470 mijë lekë. Në raport me totalin e primeve të INSIG për periudhën janar-prill 2022 kjo klasë realizon 5.09% të primeve totale të vetë shoqërisë. Ecuria e primeve bruto të kësaj klase për periudhën janar-prill nga 2018-2022 paraqitet në grafikun 17, ku vihet re që vlera më e ulët i takon vitit 2019 dhe vlera më e larta arrihet në 2021.

Grafiku 14: Ecuria e primeve Insig - klasa e sigurimeve të pronës, janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)




Burimi: AMF & INSIG

2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Në klasat e sigurimeve të tjera përfshihen llojet e sigurimeve të garancive, mallrave në transport, përgjegjësi, aviacionit dhe marinës. Në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar-prill 2022 ky grup realizon 6.33% të totalit. Sigurimi i përgjegjësi zë peshën më të madhe në këtë grup për periudhën janar-prill 2022. Sigurimet e garancive renditen të dytat në këtë grup dhe me pas llojet e tjera të sigurimeve, sipas grafikut 18.

Grafiku 15: Ecuria e primeve Insig për klasat e tjera, janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)




Klasa te Tjera,	2018	2019	2020	2021	2022
Sigurimi i garancive	4,752	5,299	5,474	7,402	6,176
Sigurimi mall në transport	0	22	0	0	57
Sigurimi i përgjegjësive	11,641	3,526	11,200	16,810	16,105
Sigurimi i avacionit	0	9,592	0	0	0
Sigurimi i marinës	215	1,841	57	637	627

Burimi: AMF & INSIG

2.5 Përpjesa e klasave të sigurimit në raport me totalin

Pesha specifike e të ardhurave të secilës klasë në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar-prill 2022, paraqitet grafikisht me si më poshtë. Nga paraqitja grafike shihet që pjesa më e madhe e primeve të realizuara vjen nga sigurimet motorike, e ndjekuar nga sigurimet e pronës, të përgjegjësive, të garancive, të aksidenteve dhe shëndetit, të marinës dhe të sigurimit të mallit në transport.

Grafiku 19:Pesha specifike e seciles klase ndaj totalit Insig, janar-prill 2022.



Burimi: AMF & INSIG

Në pasqyrën e mëposhtme kemi paraqitjen e primeve të realizuara për periudhën janar-prill 2022 për secilën klasë sigurimesh dhe ndryshimin në përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019, 2020 dhe 2021. Krahasimi është bërë edhe me periudhën janar-prill të vitin 2019, pasi viti 2020 nuk shërben si bazë e mirë krahasuese, si pasojë e ndikimit të faktorëve global, si pandemia Covid 19. Duke ju referuar krahasimit me periudhën janar-prill të vitit 2019 në total, rezulton një rritje e primeve me 16%. Referuar krahasimit sipas ndarjes në klasa, shumica e klasave rezultojmë me rritje me përjashtim të marinës që rezulton me rënie prej 66% dhe aksidenteve me rënie 56%. Gjithashtu kemi edhe sigurim avionesh për këtë periudhë të 2019-ës. Theksojmë që, rritjen më të lartë e ka dhënë klasa e sigurimeve të përgjegjësive. Vlen të theksohet fakti që, për periudhën janar-prill 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019, 2020 dhe 2021 klasat: sigurimi i

avionëve rezulton me prim vetëm për 2019 dhe sigurimi i mallit në transport rezulton me prim vetëm për 2019 dhe 2022-in.

Tabala 1:Primet e shkruara sipas klasave te sigurimit Insig, 2022/2019,2020,2021 në mijë lekë

Klasat e sigurimeve	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi '22-'19/'19	Ndryshimi '22-'20/'20	Ndryshimi '22-'21/'21
Aksidente dhe sëmundje	11,928	6,248	4,017	5,201	-56%	-17%	29%
Sigurimi motorik	271,862	241,439	275,557	315,882	16%	31%	15%
Sigurimi i marinës	1,841	57	637	627	-66%	1000%	-2%
Sigurimi i avionëve	9,592	-	-	-	-100%	0%	0%
Sigurimi i pronës	8,673	29,936	44,987	18,470	113%	-38%	-59%
Sigurimi i mallrave në transport	22	-	-	57	159%	0%	0%
Sigurimi i përgjegjësi	3,526	11,200	16,810	16,105	357%	44%	-4%
Sigurimi i garancive	5,299	5,474	7,402	6,176	17%	13%	-17%
Total	312,743	294,354	349,410	362,518	16%	23%	4%


Burimi: AMF & INSIG

3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar -Prill 2022

Referuar vlerësimit për dëmet e paguara për periudhën janar-prill 2022 shoqëria INSIG rezulton me 88.039 mijë lekë pagesa, duke pësuar një rënie me 24.70%, krahasuar me nivelin e dëmeve të paguara për periudhën janar-prill të vitit 2021 ku niveli i pagesave kapte vlerën prej 116,912 mijë lekë. **Ndërkohë numri i dëmeve të paguara është rritur afro 11.67%** ose 49 raste me shumë krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2021. Raporti dëme/prime për janar-prill 2022 rezulton të jetë 22.29%. Per INSIG 90.82% e vlerës së pagesave për periudhën janar-prill 2022 i takon sigurimeve motorrike. Ndikim më të madh në këtë grup ka dhënë TPL me 72.64% te pagesave, e ndjekur nga Kartoni Jeshil me 9.96%, Kasko me 4.15% dhe Kufitare me 4.01% . Më pas vijnë pagesat e kryera nga klasa Zjarri dhe Dëmtimet e tjera në Pronë që zënë 7.75% të totalit të pagesave pasuar nga klasa e Aksidenteve dhe Shendetit që zënë 1.15% dhe Garancite me 0.28% te totalit te pagesave për këtë periudhë analizuese. Sigurimet e Përgjegjësi rezultojnë pa deklarime rastesh për këtë periudhë të vitit 2022. Referuar buletinit të AMF-së sikurse u citua edhe te primet, në totalin e dëmeve të paguara nga klasa e sigurimeve të pronës, përfshihen pervec dëmeve te paguara nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e Tjera në Pronë edhe mbulime të tjera që ofrojnë dhe llojet e sigurimeve inxhinerike. Më poshtë,

paraqitja grafike e peshës specifike të pagesave që zë secila klasë ndaj totalit për periudhën janar-prill 2022.


Grafiku 20: Pjesa e dëmet e paguara nga llojet e sigurimit Insig, janar-prill 2022



Burimi: AMF & INSIG

Duke ju referuar ecures së pagesave në vite vihet re që, për periudhën janar-prill nga viti 2018-2022, kemi një luhajtje pagesash. Janar-prilli i vitit 2021 shënon vlerën më të lartë të pagesave dhe raportin më të lartë të dëmeve të paguara kundrejt primeve të realizuara, ndërsa janar-prilli i vitit 2022 shënon raportin më të ulët të dëmeve të paguara kundrejt primeve të realizuara. Më poshtë ecuria e dëmeve të paguara dhe raporti dëme/prime për Insig, për periudhën janar-prill 2018-2022 sipas grafikut 21.

Grafiku 21: Ecuria e dëmeve të paguara të Insig, janar-prill 2018-2022 (mijë lekë)



Burimi: AMF & INSIG

3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike


Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto siç u theksua edhe më lartë i përket sigurimeve motorrike me rreth 79,959 mijë lekë ose 90.82% të totalit të pagesave. Nga karahasimi më periudhën janar-prill të 2021, kemi një rënie prej 23.56% ose 24,641 mijë

lekë më pak. Brenda grupit 4.57% e pagesave i takon sigurimit motorik vullnetar Kasko dhe pjesa tjetër prej 93.63% i takon pagesave për sigurimet e detyrueshme motorike.

3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit

Pjesa tjetër e dëmeve të paguara vjen nga klasa e sigurimeve të pronës me rreth 6,822 mijë lekë ose 7.75% të totalit të pagesave. Raporti dëme të paguara ndaj primeve të realizuara për sigurimet e pronës është 37.12%. Për klasën e sigurimeve të pronës shoqëria INSIG në raport me totalin e dëmeve të paguara të tregut zë 1.89% të totalit të pagesave. Përsa i përket aksidenteve dhe shëndetit për periudhën janar-prill 2022, shënohen rreth 1,010 mijë lekë pagesa ose 1.15% të totalit të pagesave. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të realizuara për këtë klasë është 19.42% për periudhën janar-prill të 2022. Kjo klasë në raport me pagesat totale të tregut zë 0.50% të këtij totali. Sipas grafikut 22, jepet një paraqitje e ecurisë së pagesave për periudhën janar-prill 2021-2022 dhe ndryshim në përqindje sipas klasave të sigurimeve.

Grafiku 22: Pagesat sipas klasave dhe ndryshimi në përqindje Insig, janar-prill 2021-2022 (në mijë lekë)




Burimi: AMF&INSIG

4.Projeksiione dhe vlerësime

Për periudhën janar-prill të vitit 2022, shoqëria INSIG për aktivitetin e Jo Jetës shënoi një rritje në totalin e primeve të realizuara me rreth 3.75% ose 13,108 mijë lekë më shumë, e cila u shoqërua me rritjen e numrit të kontratave për këtë aktivitet me 27.11% ose 4,169 kontrata më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Një rritje e konsiderueshme duke marrë parasysh situatën ekonomike në botë e cila ka dhënë ndikimin e vet edhe në vendin tonë me rritjen e cmimeve dhe inflacionin. Vlen të theksohet fakti që, pavarësisht peshës aktuale në treg prej 6.74% efekti i INSIG ka ndikimin e tij pozitiv në rritjen e Tregut, po në një masë jo shumë të ndjeshme pasi të gjitha kompanitë rezultojnë me rritje për periudhën janar-prill 2022 krahasuar me janar-prill 2021. Tregu i Jo Jetës në vetvete shënon një rritje prej 8.44% dhe kjo u shoqëruar me

rritjen e numrit të kontratave në total për tregun prej 23.31% ose 55,922 kontrata më shumë. Duke ju referuar krahasimit me periudhën janar-prill të vitit 2020, INSIG rezulton me një rritje prej 23.16% ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 më një rritje prej 15.92%. Duke ju referuar ritmit të rritjes së Tregut të Jo Jete në përgjithësi dhe rritjes të INSIG-ut në veçanti, për periudhën janar-prill 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, grafikasht më poshtë vihet re se, për sigurimet vullnetare norma e rënies së INSIG-ut është shumë më e madhe se norma e rritjes së Tregut e cila është jo shumë e ndjeshme. Diferenca e Insig-ut me Tregun për sigurimet vullnetare është rreth 32.49% më pak. Mirëpo kjo vjen edhe nga baza e ulët e vullnetareve për periudhën janar-prill të vitit 2019 për INSIG. Nga ana tjetër, norma e rritjes së sigurimeve të detyrueshme për INSIG është më e lartë se ajo e rritjes së Tregut, me një diferencë prej 3.05% më shumë. Bazuar në këto tregues për këtë katër muor të parë të vitit, për shoqërinë INSIG lind nevoja në vazhdimësi për vitin 2022, fokusi të vihet te rritja e sigurimeve vullnetare. Megjithatë, sigurimet motorike të detyrueshme, të cilat ecin në të njëjtin trend me ecurinë e tregut, pritet të shënojnë rritje me përmirësimin e treguesve të tjerë ekonomik.


Grafiku 24: Norma e rritjes së tregut të sigurimeve dhe Insig, janar-prill 2022/2021



Burimi: AMF & INSIG

Trendi i primeve të tregut të sigurimeve dhe i shoqërisë INSIG ka qenë i luhatshëm dhe me shpërndarje jo normale. Sidomos gjatë vitit 2020, të gjitha modelet parashikuese rezultuan jo të sakta, si pasojë e faktorëve të mjedisit të jashtëm, ku pandemia globale Covid 19 pati ndikimin thelbësor. Bazuar në të dhënat historike të primeve për INSIG, grafikasht më poshtë sipas figures 1, paraqitet parashikimi i primeve për muajt prill 2022 – tetor 2022. Modeli parashikues është ndërtuar në tre skenar të cilët bazohen në të dhëna historike. Në figurën 1 paraqiten vetëm të dhënat historike për primet janar 2022 – prill 2022, por në ndërtimin e parashikimit janë marrë si bazë të dhënash, primet mujore që nga viti 2013 dhe projeksioni vijon deri në fund të vitit 2025. Parashikimet bazuar në të dhënat historike, nuk janë modelet më të mira parashikuese, duke marrë parasysh faktin që, mjedisi në të cilin operon shoqëria ka ndryshuar dhe është në ndryshim të vazhdueshëm.

Figura 1: Parashikimi i primeve Insig Maj 2022 – Tetor 2022 (mijë lekë)



Burimi: Të dhëna Insig, përpunoi autori